

LOGJIKË E ARISTOTELIT NË MEDRESETË SHQIPTARE**Abdulla Rexhepi *****Abstrakt**

Filozofët myslimanë, si shumë dije dhe shkenca të tjera, edhe Logjikën e huazuan nga grekët e lashtë, sidomos nga Aristoteli. Filozofi më i njohur grek në botën islame konsiderohet Aristoteli, veprat e të cilit u përkthyen në gjuhën arabe dhe trashëgimia e tij filozofike pati ndikimin më të madh në kulturën e mendimit mysliman. Në shekullin e III-të, Prophyrius Tyrius, pjesës së parë të Organonit, pra pjesës së Kategorias ia shkroi një hyrje me titull “Esagoge” (në kuptimin e Hyrjes), e cila që nga ajo kohë është cilësuar si çelës i zbërthimit të kuptimeve të veprave të Aristotelit në fushën e Logjikës. Që nga ajo kohë, kjo vepër është bërë pjesë e pandashme e përmbledhjes së veprave të logjikës së Aristotelit. Si gjithë veprat e tjera, edhe kjo është përkthyer në gjuhën arabe dhe është komentuar nga shumë logjicienë myslimanë. Madje, shumë prej tyre dhe shkruan ‘Isaguxhi, pra hyrje në fushën e Logjikës, ku më e njohura prej këtyre veprave është ajo ‘Âthîru-d-Dîn âl-Âbhârîj -ut (v.1276), vepra e të cilit njihet me emrin “*Isaguxhi*” apo “âr-Risâlâ - âl-âthârîjjâ *fî-l-Mânîk*”. Ajo ka qenë njëra ndër veprat kryesore të dijes së Logjikës nëpër medresetë e botës islame, duke përfshirë edhe medresetë e shqiptarëve. Kjo vepër, bashkë me disa vepra të tjera nga fusha e Logjikës kanë qenë pjesë të programeve mësimore nëpër medresetë shqiptare, të cilat kanë ekzistuar deri kah fundi i shekullit të kaluar. Në këtë punim, në fillim do të prezantoj dhe analizoj veprën ‘Isaguxhi të ‘Abhariut, dhe më pastaj do të përpiqem të trajtoj mësimin e kësaj vepre në medresetë shqiptare, duke u fokusuar në medresenë e hafiz Nexhatisë në Preshevë. Metodologjia e ndjekur në këtë punim është prezantative-analitike në pjesën e parë, dhe studim në terren, në pjesën e dytë.

Fjalë Kyçe: Logjika, Aristoteli, ‘Isaguxhi, ‘Abhari, medresetë shqiptare.

* Prof. Ass. Dr. i Gjuhës dhe Letërsisë perse dhe Gjuhës Osmane në Departamentin e Orientalistikës - Universiteti "Hasan Prishtina", Prishtinë.

Hyrje

Logjika është definuar si shkencë që mëton studimin e formave dhe ligjeve të të menduarit të drejtë¹. Logjika merret edhe me nocionet, gjykimet (premisat) dhe konkludimet e individit. Nga shumë dijetarë, ajo është cilësuar edhe si “çelësi i të gjitha dijeve” apo “bazë e secilës shkencë”. Megjithatë edhe para tij pati veprimtari intelektuale, Aristoteli² (384 - 322 p.e.s.) llogaritet themelues i Logjikës si disiplinë më vete. Duhet theksuar se mendimtarët grekë para-sokratikë kanë përdorur forma dhe premisa logjike në hulumtimet e tyre natyrore dhe humane-shoqërore. Veprat e pjesëtarëve të shkollës Elea dhe të sofistëve në Greqinë e lashtë, vlerësohen si parapërgatitje e themelimit të Logjikës. Kështu, Aristoteli si trashëgimtar i kësaj dijeje filozofike, me qëllim të sistemimit të të menduarit në një disiplinë më vete dhe të parandalimit të mendimit të gabuar te individët, vendosi rregulla të caktuara. Prandaj, në historinë e mendimit njerëzor ai që i pari që krijoi nocionet dhe premisat e gjyimit të drejtë. Në fakt, për Aristotelin Logjika nuk është shkencë, por është një mjet apo dije që duhet mësuar para se të merremi me ndonjë shkencë tjetër, pra është një mjet³ për

¹ Mbi definicionet për Logjikën, shih: Peter Smith. An Introduction to Formal Logic. Cambridge University Press, (6th printing) 2013. Patrick J. Hurley. A Concise Introduction to Logic. (versioni elektronik).

² Aristoteli lindi në Stagira, të Trakisë në Greqinë e lashtë, dhe u shkollua në Akademinë e Platonit. Njihet si njëri ndër filozofët më të mëdhenj të të gjitha kohërave. Ai është autor i shumë veprave, të cilat pas vdekjes së tij i përgatitën nxënësit e tij - mbi Filozofinë, Logjikën, Teologjinë, Moralin, Poezinë, Politikën, etj.. Për më tepër, shih: Ferguson, John (1972). Aristotle. New York: Twayne Publishers. Ackrill, J. L. (1981). Aristotle the Philosopher. Oxford and New York: Oxford University Press.

³ Platonistët e lashtë mendonin se Logjika është edhe pjesë e filozofisë por edhe mjet i saj, ndërsa peripatetikët mbronin qëndrimin se ajo është vetëm mjet i filozofisë. Në anën tjetër, Stoikët mbronin qëndrimin se Logjika është vetëm një pjesë e filozofisë. Edhe logjicienët myslimanë i kishte preokupuar çështja nëse Logjika është pjesë e filozofisë apo vetëm një mjet i saj. Në tekstet klasike të logjicienëve myslimanë i hasim të dy qëndrimet,

mësimin e shkencave të tjera. Logjika e Aristotelit ka qenë logjikë formale, prandaj ai, në sistemimin që ua bëri dijeve, Logjikën nuk e rradhiti në asnjërin grup prej tyre. Meqë për Aristotelin Logjika është vetëm mjet apo formë e shkencës, ajo zë vend në hyrje të dijeve dhe shkencave dhe kjo është arsyeja pse shkrimet dhe përsiatjet e tij mbi Logjikën i përmbledhën në veprën të cilën e quajtën Organon, në kuptimin e mjetit/instrumentit. Vepra Organon në fillim përbëhej nga shtatë pjesë: Kategoritë (lat. Categoriae), Interpretimet (lat. Peri hermeneias), Analitika e Parë (lat. Analytika protera), Analitika e Dytë (lat. Analytika Hystera), Topika/ Polemika (lat. Topika) dhe Argumentet sofistike (lat. De Sophisticis Elenchis). Më pas, logjicienët kësaj vepre ia shtuan edhe dy vepra të tjera të Aristotelit, Retorika (lat. Rhetorica) dhe Poetika (Peri Poietikes), si dhe veprën Eisaguge (Eisagōgē) të Porporiusit (Porphyry). Kështu përmbledhja klasike e Logjikës u hartua në nëntë pjesë, e cila më vonë me shekuj të tërë u mësua nëpër shkolla të ndryshme të botës. Tematika e këtyre ka të bëjë me terminologjinë, parimet, gjykimet, format e argumentimeve dhe demantimeve dhe, më shumë se çdo gjëje tjetër, i kushtohet vëmendje analogjisë. Edhe pse pas tij pati përpjekje të tjera të fushën e Logjikës, siç ishin stoikët, të cilët e ndanë logjikën nga metafizika dhe e futën në një dije mbi formën dhe gjuhën, megjithatë konceptet e Aristotelit mbi Logjikën vazhduan të kenë ndikim të madh qoftë në botën perëndimore, qoftë në botën islame.

pra disa prej tyre janë të mendimit se Logjika është pjesë e filozofisë, ndërsa disa të tjerë mendojnë se ajo është vetëm një mjet për mësimin e saj dhe për të menduar. Por Ibn Sina mendon se Logjiika është edhe pjesë e filozofisë por edhe mjet për të menduar dhe sipas tij, këtu nuk ekziston fare divergjencë. Megjithëse te dijetarët myslimanë i hasim qëndrimet e filozofëve të lashtë grekë, megjithatë më vonë shohim se dominon mendimi se Logjika është vetëm mjet, madje në shumë raste ajo definonet edhe si ‘mjet i dijes’. (shih: Emiroğlu, İbrahim. Mantık. në: TDV İslâm Ansiklopedisi. Vëll. 28, İstanbul, 2003.)

Logjika e Aristotelit te myslimanët

Në fillim, kur myslimanët u drejtuan kah shkencat dhe dijet greke, përkthyesit më shumë qenë të prirur të përkthenin vepra nga fusha e mjekësisë dhe astronomisë. Por pa kaluar shumë kohë, me të dalë në pah polemikat intelektuale dhe doktrinare midis myslimanëve dhe ndjekësve të religjoneve të tjera,⁴ sidomos pas daljes në skenë të shkollës mutezilite,⁵ filozofia, veçanërisht Logjika gjeti përkrahës të mëdhenj të mesin e tyre. Ekzistojnë disa faktorë që shtyen myslimanët t'u drejtohen dijeve greke në përgjithësi dhe Logjikës në veçanti, disa nga të cilat janë:

1. Në vendet ku shtrihej feja islame, krishterimi, hebraizmi dhe fetë e ndryshme iraniane, doktrinat e tyre i mbronin me metodën logjike që e kishin huazuar nga grekët. Kjo gjendje i detyroi myslimanët që edhe ata argumentet për fenë e tyre t'i sistematizonin dhe kështu u drejtuan kah logjika greke.
2. Predikimet kuranore dhe profetike për nxënien e dijes, shkencës, mendimit, përdorimin e drejt të arsyes, si dhe shumë hadithe profetike që sugjerojnë dhe inkurajojnë myslimanët të mësojnë dijet e të tjerëve.
3. Në atë periudhë, përpos debateve doktrinare dhe fetare, ndjehej gjithashtu nevoja e ngritjes së nivelit intelektual dhe spekulativ dhe sidomos kërkohesh sofistikimi i metodave të polemizimit. Ky gjithashtu cilësohet një faktor i rëndësishëm që myslimanët të thellohen në dijet e grekëve.⁶
4. Logjicienët dhe filozofët myslimanë kishin arritur në rezultatin se gjuha

⁴ Sweetman, J. W. (1954). Islam and Christian Theology. Part I, vol. I. London. pp. 64-82.

⁵ shih: Esposito, John L. (2017). Fjalor i Oxfordit për Islamin. Logos A, Shkup. f. 235.

⁶ Emiroğlu, İbrahim (2006). Ana Hatlarıyla Klasik Mantık. Asa Kitabevi.s. 48-49.

arabe nuk kishte kapacitetin e nevojshëm semantik për transferimin e koncepteve filozofike greke, prandaj ata iu qasën thellësisht Logjikës së Aristotelit dhe treguan një përpjekje të madhe në përshtatjen dhe adaptimin e terminologjisë së Logjikës, gjë që rezultoi me krijimin e një tradite të pasur në fushën e Logjikës në botën islame.⁷

Duhet theksuar se Logjika greke në botën islame hyri nëpërmjet përkthimit të veprave të Aristotelit që në shek. VI hixhri (X miladi), dhe studiuesit janë të mendimit se libri i parë i plotë i Aristotelit ishte përkthimi i tri pjesëve të para të Organonit bashkë me Hyrjen (Esagoge) e Forforiusit nga përkthyesi i njohur Abdullah Ibn Muḳaffa.⁸ Ndër përkthyesit e tjerë të Logjikës greke në botën arabe-islame llogariten edhe Juḥanna (Jahja) b. Bitrik, Abdullah b. Nʿaime el Himsi, ḥunejn b. Isʿḥaq, etj. Në arabisht qenë përkthyer të gjitha veprat e Aristotelit, madje edhe ato për të cilat ekzistonin dyshime nëse janë shkruar prej tij.

Aristoteli i arabizuar, edhe pse ndoshta nuk reflektonte sakt Aristotelin e plotë dhe të vërtetë grek, megjithatë që një përpjekje për transferimin e koncepteve dhe mendimeve nga një gjuhë në tjetrën, strukturat e të cilave dallonin shumë nga njëra-tjetra. Megjithëkëtë, duhet ta pranojmë se në të shumtën e rasteve, përkthimet e arabëve nga Aristoteli ishin shumë më besnike se shumë përkthime evropiane të veprave të tij.⁹

Përkthimet nga Aristoteli në lëmin e Logjikës (Organoni) kanë luajtur rol fundamental në krijimin e mendimit mysliman, madje ky ndikim

⁷ Safa, Zabiullah. (1378). Tarikh-e Ulum-e Aqli dar tamaddun-e Islami. Majid Publications. Teheran. s. 67.

⁸ Walzer, Richard. (1949). How Greek Science passed to the Arabs. Oxford. Oxford. p. 55.

⁹ Rescher, Nicholas. (1964). The Development of Arabic Logic. University of Pittsburgh Press. (Rescher, 1964:122)

depërtoi deri në dijen e Kelamit¹⁰ (teologjisë islame).

Logjika e përkthyer e Aristotelit, megjithë komentimet dhe zgjerimet që ia bënë logjicentë myslimanë, depërtoi thellë në mendimin filozofik dhe teologjik të mendimtarëve myslimanë, madje edhe struktura logjike e Aristotelit pati ndikim të madh edhe te metodologjia e jurisprudencës islame (Usul Fikhut). Nuk duhet lënë pa përmendur se teologët (Mutakal'limun) myslimanë e shfrytëzuan ndoshta më së shumti logjikën greke për mbrojtjen e bazave të besimit të tyre.¹¹

Përveç ndikimit të Logjikës së Aristotelit si shtyllë themelore në metodën e të menduarit të myslimanët, lirisht mund të themi se mbi gjysma e asaj që sot quhet filozofi islame është produkt i trashëgimisë filozofike të Aristotelit. Madje edhe filozofia neo-platoniste, e cila ka një influencë të madhe në krijimin e mendimit filozofik mysliman, të myslimanët ka depërtuar në emër të filozofisë aristoteliane. Ndikimi dhe rëndësia e Logjikës aristoteliane të myslimanët është aq e madhe, saqë konstatohet se “po të mos bëhej përkthimi i veprave të Aristotelit në gjuhën arabe, ndoshta nuk do të kishim filozofët e mëdhenj myslimanë si Kindi, Farabiu, Ibn Sina e Ibn Rushdi, dhe ndoshta si rezultat i kësaj, nuk do të ishin edhe filozofët perëndimorë si Albertus Magnus, Thomas Akuini, madje ndoshta

¹⁰ shih: Esposito, John L. (2017). Fjalor i Oxfordit për Islamin. Logos A, Shkup. f. 330

¹¹ Sipas Madkourit, mutekel'limët myslimanë duke filluar nga mutezilitët, esh'aritët, sidomos Imam al Haramajn Xhujeni dhe Abu Hamid Gazali në veprimtarinë e tyre intelektuale – kelamiste kanë qenë nën ndikimin e Logjikës së Aristotelit, të cilët medoemos kanë qenë njohës shumë të mirë të saj. Prof. Madkour konstaton se i pari që kishte vërejtur ndikimin e Logjikës greke te mutekellimët myslimanë qe Ibn Halduni, i cili thekson se Imam al Haramajn Xhujeni ka qenë i pari që e kishte futur metodologjinë e Aristotelit në dijet teologjike islame, konstatim ky i cili – sipas Madkour – është vërtetuar edhe në studimin e thuktë të orientalistit Macdonald. (për më tepër shih: Madkour, Ibrahim. (1375) La logique d'Aristote chez les Mutakallimun (versioni persisht i botuar në: Tahkikati Islami, Tehran, s.15).

perëndimorët nuk do të ishin njohur fare me trashëgiminë e lashtë filozofike greke”.¹²

Mendimtarët myslimanë, edhe pse e çmuan shumë Aristotelin¹³, aspak nuk hezituan që filozofinë e tij ta bëjnë objekt të kritikave të tyre. Edhe pse filozofët e parë myslimanë Farabiu dhe Ibn Sina patën kritikuar aty-këtu logjikën aristoteliane, megjithatë kritikët më të rreptë prej tyre qenë Suhreverdi (1154 -1191), filozof dhe mistik dhe Ibn Tajmije (1263 -1328), teolog. Sipas Ibrahim Madkour, Suhreverdi kryesisht nuk pajtohej me Aristotelin në dy tema mjaft të rëndësishme. E para: Sipas Suhreverdit, është shumë i vështirë realizimi i idesë së Aristotelit në lidhje me ‘sasinë’, ngase ideja e tij në këtë çështje mbështetet në konceptin e esenciales dhe quiditetit, koncepte këto që kanë të bëjnë me metafizikën. Si mund t’i definojmë cilësitë esenciale të një sendi të caktuar? Pastaj, si mund të sigurohemi se kemi përcaktuar të gjitha cilësitë e atij sendi? Kështu, reduktimi i një sendi mjafton deri aty sa të mund ta dallojmë dhe njohim atë nga sendet e tjera. Prandaj reduktimin shumë lehtë mund ta shfrytëzojmë në dije të ndryshme. Suhreverdi këtu ka parasysh rolin metodologjik të reduksionit dhe kjo qasje e tij është plotësisht e re në shkencën e logjikës. E dyta: Ai gjithashtu shpreh mospajtimin rreth katër formave të fatit, të cilat sipas tij, do të duhej të ishte vetëm një formë. Por megjithatë, Suhreverdi me Aristotelin më tepër nuk

¹² Khansari, Muhamed. (1383). *Mantek-e şouri*. Vëll. 1, Agah Publications. Tehran. s.13.

¹³ Filozofi dhe komentuesi i madh i veprave të Aristotelit, Ibn Rushd, në lidhje me Aristotelin shkruan: E falenderoj Zotin që këtë njeri (Aristotelin) e ka dalluar prej të tjerëve në përsosmëri dhe e ka vendosur në shkallën më të lartë të madhësisë njerëzore, në të cilën shkallë askush nuk arriti asnjëherë. Ndërsa në një vend tjetër thotë: Jam i mendimit se natyra këtë njeri (Aristotelin) e ka krijuar si model për të treguar fundin e përsosmërisë njerëzore. Ai është njeri, tek i cili e vërteta arriti kulmin. Shih: Horosani, Sherefuddin. (1367) *Dā'erat-ol-Ma'āref-e Bozorg-e Eslāmi*. Vëll. 22. Botim i Qendrës Dā'erat-ol-Ma'āref-e Bozorg-e Eslāmi, Tehran.

(<http://www.cgie.org.ir/fa/publication/volumes/63>) s. 606)

pajtohej për çështje definicionesh. Ndërsa Ibn Tejmije nuk kishte ndonjë kritikë të thellë logjike kundrejt Aristotelit, por më tepër luante një rol shkatërrimtar dhe ishte i mendimit që sa më parë duhet hequr dorë nga logjika dhe logjicienët. Ai që një polemizues i zjarrtë, polemikat e të cilit nuk kishin ndonjë thellësi intelektuale, por më tepër bazoheshin në sulme diskredituese ndaj Aristotelit, nëpërmjet të cilit mëtonte t'i diskreditonte filozofët myslimanë.¹⁴ Kritika konstruktive ndaj logjikës greke, sidomos asaj aristoteliane, drejtuan edhe filozofët bashkëkohorë myslimanë si Muhammâd Iḳbāl,¹⁵ Muhammâd 'Abid âl-Xhabir¹⁶ dhe Hasan Hanafi.¹⁷ Ndërsa shkaqet që në historinë e mendimit islam pati kritika ndaj logjikës së Aristotelit janë të llojllojshme dhe ka mendime të ndryshme për këtë çështje.¹⁸

Megjithatë, Logjika e Aristotelit gjeti mbështetje të pakompromis të myslimanët dhe në mënyrë sistematike u mësua nëpër shkollat dhe medresetë e tyre.¹⁹ Kështu dhe tradita e mësimi të saj shtrihej njëjtë me fenë islame nëpër rajone të ndryshme. Edhe në medresetë osmane, mësimi

¹⁴ Madkour, Ibid, f.55-56.

¹⁵ Iḳball. Muhammed. (2006) Ripërtrirja e mendimit fetar në Islam. Logos-A, Shkup. f. 16,18,164.

¹⁶ El-Cabiri, Muhammed Abid. (2001). Arap-İslâm Akılının Oluşumu. Kitabevi. Istanbul. s.266-293.

¹⁷ Hanafi, Hasan (1988) Min al aḳida ila al-thaëra. Kahire. Vëll. 2, f. 197-198.

¹⁸ Disa nga shkaqet e kundërshtimit të myslimanëve ndaj logjikës janë: a) Përpyjekja për ruajtjen e mendimit mysliman nga influenca e të huajve; b) Shqetësimi se mund të zinte vendin e dijeve islame; c) Habia apo frika nga forma e hyrjes së Logjikës në botën islame (fillimisht nga përkthyesit jomyslimanë) dhe konceptet themelore të saj (kategoritë, dialektika, analitika, induksioni, retorika, etj.); ç) Moskoordinimi i disa parimeve themelore të Logjikës me metodologjinë e hershme të kelamit; d) Qasja se Logjika e tkurrë mendimin dhe bllokoi rrugën e kënaqësisë (qasje e mistikëve); e) Qëndrimi mbi jodomosdoshmërinë e mbështetjes së dijeve në Logjikë, dhe ë) Qëndrimet emocionale (si dogmatizmi, paragjykimet, qasja pezhorative ndaj tjetrit) (shih: Emiroğlu, Ibrahim. İslâm Ansi-klopedisi, zëri Mantik, fq. 23) .

¹⁹ Badawi, Abdul-Rahman. (1978). Aristû 'inda'l-'Arab. Vekaletu-l Metbu'at Publications, Kuvajt. s. 23.

të Logjikës iu kushtua një kujdes i veçantë. Në plan-programet mësimore²⁰ në medresetë osmane shohim se krahas dijeve si Kur'ani, Tefsiri, Hadithi, Fik'hu, Akaidi, etj. mësohej edhe Logjika dhe sipas studiuesve, asaj i kushtohej një rëndësi tepër e madhe. Edhe pse nuk mund të kalojmë pa përmendur faktin se edhe në traditën e mendimit osman-mysliman, Logjika dhe në përgjithësi filozofia pati kundërshtarë të rreptë.²¹ Metodologjia e mësimi të Logjikës, si dhe temat e saj në medresetë osmane nuk dallonin fare nga ajo greko-myslimane.

Temat e veprave të logjikës që mësoheshin në medresetë osmane përbëheshin nga dy tema kryesore: 'Logjika e koncepteve' (tasavvurat) dhe 'logjika e gjykimeve' (tasdikat). Në përgjithësi, studimi i fjalëve dhe diskutimi mbi kuptueshmërinë e fenomeneve në kuadër të logjikës së koncepteve vendosej në fillim të veprave të Logjikës, sepse një gjë e tillë mendohej si hyrje në çdo dije tjetër, ku bënin pjesë pesë nocionet, si dhe diskutimi mbi njohjen si qëllimi i saj. Ndërkaq pastaj rradhiteshin parimet e logjikës së gjykimeve (tasdikat), ndërsa qëllimi i tyre që analogjia dhe argumenti. Kurse pesë artet që ngërthenin teorinë e analogjisë ishin lënë krejt në fund. Kështu dhe nëntë pjesët e logjikës klasike qenë radhitur në një formë të ndryshme (krahas radhitjes së saj te grekët e lashtë, A.R.). Në këtë formë, sistemi i logjikës te osmanët ishte bërë klishe e logjikës së periudhës së mëparshme.²²

Veprat kryesore të Logjikës që mësoheshin nëpër medresetë osmane

²⁰ Rreth programeve mësimore në medreset osmane shih: Mefail Hızlı. *Osmanlı Medreselerinde Okutulan Dersler ve Eserler*. T.C. Uludağ üniversitesi ilâhiyat fakültesi dergisi. Cilt: 17, Sayı: 1, 2008 s. 25-46; Mustafa ŞANAL. *Osmanlı devleti'nde medreselere ders programları, öğretim metodu, ölçme ve değerlendirme, öğretimde ihtisaslaşma bakımından genel bir bakış*. Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi. Sayı : 14 Yıl : 2003/1 (149-168 s.)

²¹ İzgi, Cevat (1997). *Osmanlı Medreselerinde İlim*. Cild 1, İz Yayıncılık. İstanbul. s.117.

²² Emiroğlu, İbrahim (2003). Mantık. Në: TDV İslâm Ansiklopedisi. Vëll. 28. s.23.

ishin: 'Isaguxhi e Abhariut, Kiştaşu'l 'Afkar fi taḥḫiḳi'l 'Asrar e Muhammed b. Eshref Samarkandit, Metali'ul 'Anvar e 'Urmevi dhe Sherḥu-sh Shemsije e Molla Fanarit. Meqë vepra 'Isaguxhi e 'Abhariut ishte kryesorja dhe kishte indikimin më të madh në mendimin e myslimanëve të Perandorisë Osmane (ku bënë pjesë edhe myslimanët shqiptarë), atëherë në këtë punim do të prezantoj vetëm këtë vepër dhe historikun e mësimit të saj te shqiptarët.

Meqë 'Isaguxhi e 'Abhariut është shkruar si vazhdimësi e traditës së 'Isaguxhive në trashëgiminë logjike të myslimanëve, do të ishte mirë në fillim të prezantohet shkurtimisht vepra e parë e këtij lloji, pra vepra Esagoge e Porporiusit.

Esagoge e Porporiusit

Më sipër u tha se veprës Organon të Aristotelit më vonë iu bashkangjiti edhe vepra Eisagoge (Eisagōgē) e Porporiusit (Porphyry).²³ Ky i fundit, këtë vepër e shkroi derisa po qëndronte në Sicili, me kërkesë të një pushtetari romak. Ky traktat, në të vërtetë, është komentim i koncepteve universale që njihen te Aristoteli, e që janë: gjinia, lloji, diferenca, aksidenca e veçantë dhe aksidenca. Në veprat e logjikës në gjuhën arabe dhe në ato latine të mesjetës, këta pesë koncepte quheshin edhe si 'idetë thelbësore'. Porporiusi në këtë traktat diskuton për ekzistencën e pesë koncepteve thelbësore dhe për lidhjet e tyre mes veti, por nuk lëshohet shumë në analiza më të thella. Ai në këtë vepër, duke u mbështetur në të dhënat dhe idetë e Aristotelit të shtruar në vepra të ndryshme të Logjikës dhe Metafizikës dhe duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe një stil që i shkon Logjikës, sqaroi edhe më tej pesë konceptet thelbësore aristoteliane. Duhet vënë theksin se këta koncepte nuk janë të

²³ Porporius (Porphyry) (304-234 p.e.s.) qe filozof neoplatonist, nxënës i Plutinit i cili kishte përgatitur e redaktuar veprat e mësuesit të tij.

krijua prej Porporiusit, siç mendojnë shumë njerëz.²⁴ Edhe pse kjo vepër nuk sillte ndonjë risi të veçantë, por pati fatin që të komentohet dhe interpretohet nga shumë interpretues të veprave të Aristotelit. Me këtë vepër të shkurtër, Porporiusi u bë i njohur po aq sa profesori i tij Plutini dhe e shtriu ndikimin e tij në rrjedhat e mëpastajme të filozofisë në Lindje dhe në Perëndim. Esagoge aq shumë përfitoi nam dhe rëndësi sa që në Mesjetë arriti të shndërrohet në referencën kryesore për lëndën e Logjikës. Ajo u përhap edhe në Lindje, duke u përkthyer në fillim në gjuhën sirianite dhe pehlevite (persishtja e vjetër) dhe më pas në gjuhën arabe dhe kështu pati një shtrirje të gjerë edhe në mesin e filozofëve myslimanë²⁵. Përkthyesi i saj nga sirianishtja në arabisht qe Abu Uthman Dimeshki (v. 914). Ndërsa 'Isaguxhia më e njohur te myslimanët është ajo e Ethiruddin 'Abhari'ut (v. 1265).²⁶

'Isaguxhia e Athiruddin al-'Abhariut

Vepra e "âr-Risâlâ âl-âthârijjâ *fi-l-Mânîk*" apo në original 'Isaguxhi

²⁴ Emiroğlu, İbrahim (2006). Ana Hatlarıyla Klasik Mantık. Asa Kitabevi.s.37.

²⁵ Në mesin e filozofëve myslimanë që shkruan dhe komentuan 'Isaguxhinë e Porporiusit janë: Jakub b. Ishak El Kindi, Kitab fi'l medhal bi – istifa'I-ḳavli fih, Risale fi'l-medḥali'l mantiḳi bi'htisharin ʿe ixhaz dhe Risale fi'sh – shavti'l –ḥamse; Ibnu't Tajjib Es Serhasi, Ihtisharu Kitabi 'Isaguxhi; Muhammed b. Zekerijja er Razi, Kitabu 'Isaguxhi dhe Ebu Nasr Farabi, Kitabu 'Isaguxhi ej el-Medḥal. Duhet theksuar se edhe Ibn Sina pjesën e Logjikës së Shifa-s e fillon me një 'Isaguxhi (Hyrje), ku polemizon me mendimet dhe idetë e Porporiusit.

²⁶ Nuk ekzistojnë shumë të dhëna për jetën e Ethiruddin 'Abhariut. Disa studiues mbrojnë qëndrimin se ai ka lindur në Musul, ndërsa disa të tjerë në Isfahan ose Zenxhan, por ata pajtohen se ai i takon një familjeje nga Samarkandi. Ekzistojnë gjithashtu dyshime për datat e lindjes dhe të vdekjes së tij. Mësimet e para i mori në Musul dhe më pas ato i vazhdoi në Horosan dhe Bagdad. Përveç 'Isaguxhisë, ai shkroi edhe 11 vepra të tjera, ku disa prej tyre janë: Hidajetu-l ḥikme, Tenzilu-l -efkar fi ta'dili'l – esrar, Keshfu'l ḥaḳaiḳ fi tahriri-d – deḳaiḳ, etj. Vlen të theksohet se ai në literaturën islame njihet si filozof, astronom, matematikan, logjicien dhe teolog. Për jetën dhe veprën e tij më gjerësisht shih: İslâm Ansiklopedisi, zëri: Ebharî, Esiruddin). Ünlü Türk Mantıkçısı Ebherî ve Mantık Kuralları Risâlesi", përktheu Hüseyin SARIOĞLU. İlmî Araştırmalar, XI (İstanbul 2001), 151-165.

(arabisht: *إيساغوجى في علم المنطق*, i transliteruar si *Īsāgūṭī*) siç njihet më shumë, e shkruar nga 'Āthīru-d-Dīn al-Ābhārī, është vlerësuar si adaptim i veprës së Porporiusit, si komentim dhe si përkthim i kësaj vepre.²⁷ Në këtë vepër janë përmbledhur gati të gjitha temat e Logjikës së asaj kohe dhe kjo është arsyeja e të gjithë atyre komentimeve dhe shkrimit të margjinave të kësaj vepre. 'Isaguxhie' Abhariut ka përmbledhur të gjitha temat e Organon të Aristotelit, 'Isaguxhinë e Porporiusit, por temat i ka të radhitura sipas veprave të Farabiut dhe Ibn Sinasë, ndërsa konceptin e shënjueshmërisë (*delalet*) e trajton përpara pesë koncepteve thelbësore të trajtuara nga Porporiusi. Ndërkaq ngjashmëria e vetme e veprës së Abhariut me atë të Porporiusit është trajtimi i koncepteve thelbësore të veprës 'Isaguxhi të Porpurisit edhe pse shumë shkurt. Duke i qëndruar besnik traditës aristoteliane të Logjikës, 'Abhariau njëjt si Ibn Sina veprën e tij e fillon me analizën e gjuhës dhe fjalës e jo të objekteve. Pastaj trajton llojet e fjalës dhe definimit të definicionit nga pesë fjalë, dhe kalon te llojet, aksidencat e veçanta, diferenca, analogjia, analogjia kategorike dhe ajo hipotetike, hipoteza, dhe pasi diskuton për karakteristikën e secilës, kalon te argumentimi, te mbështetja e argumentit në dije të saktë dhe më pastaj diskuton për të vërtetën, hipotetiken, dhe libri përfundon me definicionet e analogjisë dialektike, retorike, poetike dhe sofistike. Brenda librit hasim pjesët e logjikës të radhitura në mënyrë sistematike, ku njihemi me përshkrimin, definimin dhe analizën e shkurtër të të gjitha koncepteve të Logjikës. Gjithashtu pas çdo definicioni dhe përshkrimi jepet edhe shembulli për te.

²⁷ Atademir, Hamdi Ragip. (1948). Porphyrios ve Ebheri'nin Isagoci'leri. DTCCFD, VI/5. s. 464.

Faksimile nga faqja e parë e librit 'Isaguxhi e 'Abhariut, e marrë nga biblioteka e Mulla Fejzullah ef. Salihu nga fshati Geraj/Preshevë



Prandaj, vepra 'Isaguxhi e 'Abhariut, për nga struktura dhe përmbajtja, më shumë i ngjan 'Isaguxhisë (Hyrjes) së Ibn Sinasë sesa 'Isaguxhisë së Porporiusit,²⁸ por megjithatë ajo trajton edhe pesë konceptet thelbësore të 'Isaguxhisë së Porporiusit dhe mund të thuhet se është vazhdim i kësaj tradite në fushën e Logjikës. Vlen të theksohet se pas 'Abhariut, të gjitha

²⁸ Bingöl, Kuddüs. (2010). "Türk-İslam Kültür Dünyasında İsgoju", İslami İlimler Degisi. Yıl 5, sayı 2., 2010. s.169.

studimet dhe komentimet janë për-qendruar në veprën e tij dhe ajo u komentua, u përkthye dhe u botua në shumë gjuhë të botës. Komentimi më i njohur i saj është “El Feva’idul - Fenariyye” i Molla Fenari’ut dhe “El-Muṭala” i Muhammed el-Ensari el-Kaḥiri’iut. Në latinisht është përkthyer nga P. Thomas Novariensis dhe është botuar në Romë në vitin 1625. Duhet përmendur se kjo vepër është komentuar edhe nga dijetari boshnjak Mustafa Ejubović (1651-1704), i cili pas kthimit nga studimet në Stamboll, e kishte përkthyer dhe e kishte bërë të mundur atë të mësohet nëpër medresetë e Bosnjës dhe Hercegovinës.²⁹ Duhet theksuar se në Bosnjë, logjika e Aristotelit gjithashtu është mësuar edhe në medrese, por edhe nëpër shkollat e kishave ortodokse³⁰, gjë që mund të thuhet se është mësuar edhe në medresetë dhe kishat ortodokse në trevat shqiptare. Kjo vepër nga gjuha greke në atë arabe është përkthyer edhe nga Mehmed Esad Janina (Mehmed Esad b. Ali b. Osman el-Yanyevi (v. 1143/1730), një dijetar e njohës i madh i filozofisë dhe logjikës me prejardhje shqiptare. Esad Janina këtë përkthim të Esagoges bashkë me një përmbledhje nga pjesët e Kategorive, Peri Hermeneias, Analitikat I dhe II të Aristotelit e ka titulluar “Terxhimetu-sh Sherḥi’l Anvar”. Këtë vepër ai e ka përkthyer duke u bazuar në komentimin e Ioaniss Kuttiniusit, por ka edhe komentime dhe analiza të tij personale.³¹

²⁹ Kundakçi, Deniz. (2012) “Mantık ve Felsefe Eğitiminin Bosna-Hersek'teki Tarihsel Gelişimi”. Kastamonu Üniversitesi Eğitim Fakültesi Dergisi Cilt: 20, No:2, s. 689-700. s.692.

³⁰ Ibrulj, Nijaz. (2009) Bosnia Porphyriana: An outline of the development of Logic in Bosnia and Herzegovina. SURVEY - Periodical for Social Studies. No: 1. Page: 109-165. p.111.

³¹ Sarikavak, Kazim (2013). Yanyali Esad Efendi. Në: TDV İslâm Ansiklopedisi. Vëll. 43. s.323.

Për traditën e mësimi të kësaj vepre në medresetë e Ballkanit shkruan edhe studiuesi i njohur bashkëkohor, Shehab Ahmed, ku thotë: “Nga Ballkani në Bangladesh, studentët e medreseve studionin tekstet të ngjashme, si: Veprat themelore të Logjikës siç është ‘Isaguxhi e ‘Abhariut.’”³² Kjo vepër në medresetë e Perandorisë Osmane, pra deri në themelimin e Republikës së Turqisë, ka qenë teksti kryesor i lëndës së Logjikës (Islam Ansiklopedisi, zëri ‘Isaguxhi), ndërsa në botën shqiptare ka vazhduar të mësohet edhe përgjatë shekullit XX.³³ Është për t’u theksuar se kjo vepër është mësuar edhe në Universitetin e Az’harit deri në vitet e 50-të të shek. XX.

Logjika e Aristotelit në medresetë shqiptare

Me shtrirjen e Perandorisë Osmane nëpër rajonet tona, njëkohësisht ndërtoheshin dhe objektet fetare dhe arsimore të kësaj perandorie, siç janë xhamitë, teqetë dhe medresetë, ku këto të fundit qenë shtyllë e arsimit në perandori.³⁴ Padyshim se medresetë e trojeve tona funksiononin sipas planeve dhe programeve organizative dhe mësimore të medreseve të Perandorisë Osmane. Po ashtu tekstet mësimore, metodologjia e mësimi dhe organizimi i medreseve shqiptare nuk dallonin aq nga medreset osmane. Hulumtimi nëpër bibliotekat e dijetarëve myslimanë shqiptarë të

³² Ahmad, Shahab (2015). What Is Islam? - The Importance of Being Islamic. Princeton University Press. s.76.

³³ Ende nuk kam të dhëna nëse kjo vepër është komentuar dhe përkthyer në shqip nga ndonjë dijetar shqiptar. Ndërsa talebet e medreseve në trevat shqiptare kanë pasur rastin të mësojnë këtë vepër bashkë me komentimin në turqisht apo shqip që ia bënin mësuesit (muderrizët), por të komentuar në shkrim nuk e ka bërë, aq sa kam njohuri, asnjëri prej tyre. Nga intervista me disa hoxhallarë, ish-talebe të merdeses së vjetër të Preshevës, u njoftova se hoxha-mësuesi i tyre i ka përkthyer në shqip ato pjesë të cilat këta nuk kanë arritur t’i kuptojnë në arabisht dhe turqisht. Ndërsa kopjet që i posedonin hoxhallarët e Preshevës janë botime të ndryshme të shtypura në Stamboll.

³⁴ Demir, Nexhati. (2013). Arsimi dhe edukimi në Kosovë përgjatë viteve 1877-1912. Revista Hikmet, numër 1 dhe 2. Prishtinë. f.23.

gjeneratave të vjetra, si dhe librat e botuar dhe dorëshkrimet nëpër arkivat dhe bibliotekat shqiptare, dëshmojnë se librat që janë mësuar nëpër medresetë e botës islame, janë mësuar edhe tek ne³⁵. Në mesin e këtyre shohim edhe librin ‘Isaguxhi’ të Abhariut. Pra, ekzitojnë fakte empirike se vepra ‘Isaguxhi e Esiruddin Abhariut është mësuar edhe në medreset shqiptare, madje në rajonin e Preshevës është mësuar deri në vitet 80-të të shekullit të kaluar. Këtë vepër e posedon gati secili talebe i medreseve të vjetra. Ajo mund të haset edhe në arkivat e në bibliotekat tona.

Në bazë të ixhāzetnāmeve që kemi marrë në shqyrtim dhe burimeve të tjera, kemi parë se ndër veprat që janë mësuar nëpër rushdijet dhe në idādiyet, dhe sidomos në medresetë tona janë edhe veprat: Isāguxhī” - Vepër nga logjika, në gjuhën arabe, e autorit Athīru-d-īn Mufaḍḍal b.‘Umār āl-‘Abhārī (vdiq më 663/1265) dhe, “Fenārī” , që është një koment i veprës "Isagūxhi" të Ethiruddīn el-‘Ebhariut, të cilin koment e ka bërë Şemsuddīn Muhammed b. Hamza el-Fenārī (vdiq më 834/1430). Vepra njihet me emrat "El-Fevāidu ‘l-Fenāriye" ose "Sherh el-Isāguxhī lil-Fenārī". Një kopje e kësaj të fundit në dorëshkrim ruhet në Arkivin e Kosovës, kopjimin e së cilës e ka bërë Muhammed b. haxhi Hasani në vitin 977/1570.³⁶

Medresja e Preshevës apo siç njihet si Medresja e hfz. Nexhatisë, e themeluar nga hfz. Nexhati Mehmeti, i cili si një trashëgimtar i një tradite të pasur hoxhallarësh e dijetarësh, qe shkolluar edhe në medresenë e njohur

³⁵ Në mesin e librave të bibliotekës së trashëguar nga gjyshi im, Mulla Rexhep Rexhepi, por edhe të hoxhallërve tjerë, janë edhe librat që janë mësuar nëpër medrese, si: *Emsile* (pa autor), *Bina* (pa autor), *Maḳsud Mulṭeḳa* e autorit Ibrahim b. Muhammed el-Halebi, *Izzi* e autorit Izeddin ‘Abdulvehāb b. Ibrahim ez-Zinxhani, e shumë libra tjerë. Po ashtu, edhe në bibliotekat e hoxhallarëve më të vjetër, shumë nga të cilët tashmë kanë ndërruar jetë (si hfz. Nexhati Ahmeti, Mulla Fejzullah Salihu dhe Mulla Nazmi Mehmeti) ndodhen librat kryesorë të medreseve të asaj kohe, pa harruar edhe shumë libra të tjerë të dijeve islame.

³⁶ Mehmeti, Sadik. (2008) Dorëshkrimet orientale në Arkivin e Kosovës, Prishtinë. f.106.

Medah të Ataullah Efendiut në Shkup,³⁷ arriti të shkollojë tri gjenerata talebesh, prej së cilës dolën dijetarë dhe myderriz të shquar të kësaj treve. Më i dalluari prej tyre qe Mulla Fejzullah Salihu (në popull i njohur si Mulla Fejza) tek i cili mësuan një numër i konsiderueshëm talebesh.³⁸

Këta hoxhallarë përpos veprave të tjera që i kanë mësuar e studiuar, flasin edhe për 'Isaguxhinë e 'Abhariut. Krahës kësaj vepre, ata prej librave të lëndës së Logjikës (Mantik) përmendin edhe Mugni't- tūl'lab, si komentim të 'Isaguxhisë. Sipas tyre, edhe kjo vepër, ashtu si librat e tjerë, është lexuar në gjuhën arabe, pastaj është komentuar dhe shpjeguar në gjuhën turke dhe shqipe. Ndërsa, ata më shumë kanë qenë të përqendruar të lexojnë dhe mësojnë komentimin e 'Isaguxhisë, pra librin Mugni't- tūl'lab³⁹. *Mantikun (Logjikën) e mësonim, siç thonë ata, për me mund me dallu të mirën nga e keqja, hakun prej johakut dhe të drejtën nga e shtrembëra. Ajo që kanë mbajtur në mend nga kjo libër është zbërthimi i emrit 'Isaguxhi, të cilin e thonë në këtë mënyrë: Is(ايس) (-ente, agu(اغو) – ene dhe exhi ose xhi (اخي) – fi hadhel meqan. (dmth: Is-ti, agu-unë dhe xhi-në këtë vend)⁴⁰. Një gjë të tillë e hasim edhe në librin Mugni't-tūl'lab, por sigurisht që një zbërthim apo interpretim i tillë i emrit 'Isaguxhi është i*

³⁷ Bislimi, Taxhedin. (2011). "Medreseja Medah" e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj. Shkup. f. 61.

³⁸ Prej të cilëve kam intervistuar Mulla Shenasi Fejzullahin, Mulla Xhemal Musliun, Mulla Behxhet Idrizin dhe hfz. Avni Ahmetin nga komuna e Preshevës dhe Bujanocit.


³⁹ Stili i veprave klasike në logjikë dhe filozofi ka qenë që të shkruhej me fjali sa më të shkurtra dhe në mënyrë sa më të përmbledhur e më të ngjeshur. Prandaj këto vepra duhej të mësoheshin nga ndonjë mësues i cili po ashtu ka mësuar te ndonjë mësues tjetër, e kështu më radhë. Ishte e pamundur që veprat në fjalë të kuptoheshin pa ndihmën e një mësuesi, apo pa lexuar ndonjë komentim ose margjinat (hashije) të shkruara në këto vepra.

⁴⁰ Këtë ma kanë thënë gjatë intervistës Mulla Shenasi Fejzullahin, Mulla Xhemal Musliun dhe hfz. Avni Ahmetin.

gabueshëm, ngase siç është thënë edhe më sipër, 'Isaguxhi është një theks arab i fjalës greke "eisaguge" në kuptimin e hyrjes. Interpretime të tilla të paqëndrueshme mund të shihen në shumë komentime dhe analiza që gjatë historisë i janë bërë kësaj vepre.

Në margjinat e shkruara të disa botimeve të kësaj vepre, edhe pse ky emër i atribuohet çdo libri përgatitor ose hyrës për ndonjë libër tjetër më të rëndë për t'u kuptuar, megjithatë përmendet se 'Isaguxhi është term i lëndës së Logjikës. Pastaj, edhe pse është përmendur në disa burime se kuptimi i kësaj fjale është 'Hyrje', përsëri diku-diku shohim se janë dhënë edhe kuptime të tjera, madje është pretenduar se 'Isaguxhi' ka qenë emër i një filozofi ose i një nxënësi të një filozofi, madje janë hedhur edhe ide se kjo fjalë është nga gjuha sirianite e jo greke e gjepura të tilla të paqëndrueshme.⁴¹

⁴¹ Atademir, Hamdi Ragip. (1948). Porphyrios ve 'Abhari'nin Isagoci'leri. DTCFD, VI/5. s. 467.



Faksimile nga faqja e gjashtë e librit “Mugni't-ful'lab” e marrë nga biblioteka e

Mulla Fejzullah ef. Salihu nga fshati Geraj/Preshevë

Metoda e mësimimit të kësaj vepre njëjtë si veprat e tjera, ka qenë e tillë: në disa raste mësimdhënësi e ka lexuar tekstin në arabisht, pastaj e ka analizuar atë fjalë për fjalë në aspektin filologjik, dhe në fund e ka komentuar në gjuhën turke ose në shqipe, kurse ndonjëherë teksti është

lexuar nga ndonjë talebe dhe më pas është komentuar nga mësimdhënësi. Sipas këtyre hoxhallarëve, mësimi i këtyre veprave si kjo e 'Isaguxhisë, ndihmon të kuptuarit e teksteve fetare islame, sepse pa mësuar mantikun (logjikën), ilmul-bejanin (retorikën) e lëndë të tjera si këto, nuk mund ta kuptojmë si duhet Kuranin dhe hadithin.

Prezenca e kësaj vepre në bibliotekat e secilit hoxhë të shkolluar në sistemin e medreseve të vjetra është një dëshmi për pozitën e lartë që ka patur ajo në syllabuset e atyre medreseve dhe një gjë e tillë më shtyn të mendoj, sidomos nëse kihen parasysh edhe veprat tjera mbi Logjikën në bibliotekat e tyre, rreth rëndësisë që ata i jepnin Logjikës në shkollimin, mendimin dhe më pastaj në veprimtarinë e tyre fetare.⁴² Por, gjatë bisedave me këtë gjeneratë të fundit të talebeve të medresesë së vjetër të hfz. Nexhatisë, të cilët tashmë janë në një moshë të shtyrë, për mua që e pamundur të kuptoj ndikimin e veprës së 'Isaguxhisë dhe sidomos te këta persona të has në gjurmët e Logjikës aristoteliane. Po ashtu, është interesant fakti se ata ishin të njohur me filozofët dhe logjicienët më të mëdhenj të botës myslimane, si Kindi, Farabiu, Ibn Sina, Rrazi, Taftazani etj., madje atyre u kujtohej dhe Aristoteli (Aristu, siç thonë ata). Duke pasur parasysh kushtet dhe rrethanat politike të kohës kur kjo medrese funksiononte, pa dyshim se duhet ulur pritjet për ndikimin e ideve dhe koncepteve të mëdha logjike-filozofike. Por nëpër ligjëratat dhe derset e këtyre hoxhallarëve dhe sidomos në bisedat që kam zhvilluar me ta, merret vesh se ata kanë njohuri për dialektikën, retorikën, estetikën dhe analogjinë. Për këtë ata mund të kuptojnë shumë mirë veprat klasike arabe, veçanërisht

⁴² Një gjë e tillë aspak nuk mund të vërhet tek hoxhallarët e mëvonshëm të shkolluar nëpër vendet arabe, sidomos në ato të Arabisë Saudite. Për fat të keq, te kjo shkollë teologjike mbizotëron një frymë armiqësore kundrejt Logjikës dhe Filozofisë, dhe si rezultat, myslimanët shqiptarë janë duke u ballafaquar me interpretime tepër radikale dhe anakronike të fesë tyre.

poezinë dhe prozën klasike arabe. Edhe një gjë nuk duhet harruar, Logjika dhe Filozofia që mësohej në atë kohë, në të gjitha medresetë ishte në shërbim të kelamit dhe apologjisë fetare.

Përfundim

Logjika e Aristotelit gjeti shtrirje të madhe në mesin e medreseve dhe dijetarëve myslimanë, kurse veprat e tij u përkthyen dhe u komentuan herë të tëra. Kështu ai pati ndikimin më të madh në mënyrën dhe metodën e të menduarit, të argumentuarit dhe të krijimit të koncepteve dhe ideve të mendimtarëve myslimanë. Një gjë të këtillë padyshim se shumë pak mund ta hasim në traditën mistike të botës islame. Vepra që e bëri edhe më të kuptueshme dhe më të njohur Logjikën e Aristotelit te myslimanët, padyshim se qe 'Isaguxhi e Porporiusit, e cila u përkthye, u komentua, madje edhe u shndërrua në model të shumë veprave të dijetarëve myslimanë në fushën e Logjikës. Duke pasur për model këtë vepër, filozofët dhe dijetarët myslimanë shkruan 'Isaguxhi të tjera, ku më e njohura prej tyre është ajo e 'Athīru-d-đīnāl-'Abhariut. "ar-Risāla āl-Athirije fi-l-Mantīq" apo 'Isaguxhi' e 'Abhariut qe vepra më e komentuar dhe e përkthyer në gjuhët e Lindjes dhe të Perëndimit dhe qe bërë tekst mësimor nëpër medresetë e myslimanëve anëmbanë botës islame. Kjo vepër gjithashtu mësohej edhe në medresetë e Perandorisë Osmane, si vazhdimësi e tyre edhe në medrsetë shqiptare. Vepra e 'Abhariut ishte mësuar deri vonë në medresenë e hfz. Nexhatisë në Preshevë dhe në talebet e tij edhe sot e kësaj dite mund të flasin për të. Është tepër e vështirë të identifikohet sasia dhe cilësia e ndikimit të kësaj vepre në mënyrën e të menduarit të këtyre hoxhallarëve. Megjithatë, Logjika që mësohej në këto medrese ishte në shërbim të teologjisë dhe apologjisë fetare dhe jo ndonjë veprimtari e pavarur intelektuale.

Aristotle's Logic in Albanian Madrasas

Abdulla Rexhepi *

Abstract

Muslim philosophers borrowed Logic like many other sciences from the ancient Greeks, especially from Aristotle. Aristotle's thoughts and opinions on Logic were gathered by his students in a philosophical work named "Organon". In the third century Prophyrius Tyrius, the Neo – Plotinian philosopher wrote an introduction to the first part of "Organon", to the Category part which he titled 'Esagoge'. The best known of which was the one of Ethiruddin 'Abhari (1276), whose work is known as "Esagoge" or "Risale Ethirije fi'l Mantıq". This work, along with other works in the field of Logic, was part of the teaching program in Albanian madrasas, which existed till the end of the last century. In this paper, first I will introduce and analyze the work Esagoge of 'Abhari and then I will try to talk about learning this work in Albanian madrasas, focusing on the Hafiz Nexhati's Islamic school in Preshevo.

Keywords: Logic, Aristotle, Esagoge, 'Abhari, Ottoman - Albanian madrasas, Madrasa of Hafez Nexhati.

* Prof. Ass. Dr. of Persian language & literature and Ottoman-Turkish language, Department of Oriental Studies, University "Hasan Prishtina", Pristina.